

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ALB-ENERGY" sh.p.k është themeluar më 14 shkurt 2015 dhe është regjistruar më 3 mars 2015 në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është ndërtimi, operimi, administrimi, mirëmbajtja, shfrytëzimi dhe transferimi i hidrocentraleve, si dhe marrja përsipër e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga kontrata koncensionare., prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike, si dhe çdo lloj veprimtarie dytësore që lidhet me veprimtarinë kryesore.

Administrator i Shoqërisë është Z. Pëllumb Beta.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L51503039D. Selia qendrore e saj është në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga Asim Vokshi, Nd.14, H.4, Ap.6, 1016.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 18 punonjës. (2018: 24 punonjës). Numri i punonjësve në fund të vitit 2019 i ndarë sipas kategorive është:

- 1 administrator
- 1 ekonomiste
- 1 elektrikist
- 1 inxhinier
- 1 mekanik
- 1 mjeke
- 6 operatorë kompjuterash
- 1 punëtor
- 4 roje sigurimi
- 1 shofer

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përkrahur më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3 Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese kanë filluar të lehtësohen, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3 Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
EUR/Lek	121.77	123.42
USD/Lek	108.64	107.82

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.

Aktivitet jo-materiale të krijuara nga marrëveshja koncesionare janë amortizuar në bazë të periudhës koncesionare.

3.5.1 Marrëveshjet Koncesionare

Një marrëveshje koncesionare e shërbimeve është një marrëveshje ku një qeveri ose një organ tjetër i sektorit publik (koncesiondhënësi) kontraktin një operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivet e infrastrukturës së koncesiondhënësit si rrugë, ura, tunele, aeroporte, rrjete të shpërndarjes së energjisë, burgje apo spitale. Në këto marrëveshje, koncesiondhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivet, kujt duhet t'i sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënës në aktive në fund të afatit të marrëveshjes.

Shoqëria ka njohur aktivet e krijuara nga marrëveshja koncesionare sipas modelit të Aktivit Jomaterial. Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licensën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivit jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK5 Aktivitet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë	178,912,748	421,711,288
Në Lekë	35,431,580	126,524,340
Në monedhë	143,481,168	295,186,948
Mjete monetare në arkë	40,629,486	41,236,256
Në Lekë	633,473	1,268,525
Në monedhë	787,121	797,787
Depozita afatshkurtra fleksibël	39,208,892	39,169,944
	219,542,234	462,947,544

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Klientë	-	21,542,954
	-	21,542,954

6. Llogari tatimore të arkëtueshme

Llogaritë tatimore të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Parapagim i tatimit mbi fitimin	15,662,950	542,497
	15,662,950	542,497

7. Të ardhura të përllogaritura

Të ardhurat e përllogaritura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Klientë për energji të prodhuar të pafaturuar	56,226,642	26,858,053
	56,226,642	26,858,053

8. Inventarë

Vlera e inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Materiale të para	11,890,057	10,867,522
Inventar i imët	1,753,034	1,712,717
Zhvlerësimi inventarit të imët	(943,419)	(943,419)
	12,699,672	11,636,820

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime të periudhave të ardhme	1,421,228	1,320,050
Parapagime për furnitorë	52,425	52,425
	1,473,653	1,372,475

10. Aktive financiare

Llogaria e aktiveve financiare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Depozita afatgjata në bankë	18,800,000	18,800,000
	18,800,000	18,800,000

ALB-ENERGY sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lekë)

11. Aktive Afatgjata Materiale

Kosto	Mjete transporti	Makineri dhe pajisje	Pajisje informatike dhe teknike	Mobilje e pajisje zyre	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	6,034,313	9,548,054	5,382,732	156,475	2,188,968	23,310,542
Shtesa	-	54,166	101,632	-	-	155,798
Transferime		(6,870,528)				(6,870,528)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	6,034,313	2,731,692	5,484,364	156,475	2,188,968	16,595,812
Shtesa	-	-	8,712	16,667	1,310,210	1,335,589
Gjendja më 31 dhjetor 2019	6,034,313	2,731,692	5,493,076	173,142	3,499,178	17,931,401
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2018	2,164,974	1,251,234	2,825,606	52,773	944,600	7,239,187
Amortizimi i vitit	773,868	289,772	646,889	20,741	248,874	1,980,144
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,938,842	1,541,006	3,472,495	73,514	1,193,474	9,219,331
Amortizimi i vitit	619,094	238,137	503,511	16,592	371,212	1,748,546
Gjendja më 31 dhjetor 2019	3,557,936	1,779,143	3,976,006	90,106	1,564,686	10,967,877
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2018	3,095,471	1,190,686	2,011,869	82,961	995,494	7,376,481
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,476,377	952,549	1,517,070	83,036	1,934,492	6,963,524

ALB-ENERGY sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lekë)

12. Aktive Afatgjata Jomateriale (Konçensionit)

	HEC BELE 2	HEC TOPOJAN 1	Pjesa e Nënstationit	Rrethimi i Objektivit	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2018	1,194,646,591	679,189,202	229,733,453	6,643,073	2,110,212,319
Transferime	6,870,528	-	-	-	6,870,528
Pakësime	(3,261,000)	-	-	(1,553,200)	(4,814,200)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,198,256,119	679,189,202	229,733,453	5,089,873	2,112,268,647
Shtesa					
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,198,256,119	679,189,202	229,733,453	5,089,873	2,112,268,647
Zhvlerësimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2018	186,890,748	90,338,834	28,708,124	557,543	306,495,249
Zhvlerësimi i vitit	37,373,428	21,809,273	7,445,383	225,390	66,853,474
Pakësime	(737,700)	-	-	(229,097)	(966,797)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	223,526,476	112,148,107	36,153,507	553,836	372,381,926
Zhvlerësimi i vitit					
Gjendja më 31 dhjetor 2019	37,447,500	21,809,273	7,445,383	169,919	66,872,075
Gjendja më 31 dhjetor 2019	260,973,976	133,957,380	43,598,890	723,755	439,254,001
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 dhjetor 2018	974,729,643	567,041,095	193,579,946	4,536,037	1,739,886,721
Gjendja më 31 dhjetor 2019	937,282,143	545,231,822	186,134,563	4,366,118	1,673,014,646

13. Hua

Llogaria e huave më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë nga OTP	51,516,625	52,214,682
Kredi afatgjatë OTP	299,490,587	355,763,055
	351,007,212	407,977,737

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaria e të pagueshmeve tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të pagueshme tregtare	16,312,287	35,254,669
	16,312,287	35,254,669

15. Detyrime Tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
TVSH për t'u paguar	7,674,910	1,009,509
Tatim në burim	65,756	66,647
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetsore	272,067	342,287
Detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale	81,798	93,947
Të tjera	881	-
	8,095,412	1,512,390

16. Të tjera detyrime

Llogaritë e detyrimeve të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paga për t'u paguar	281,564	945,329
	281,564	945,329

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2019 ishte 18 punonjës (2018: 24 punonjës)

17. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Hua nga palët e lidhura - Alb Building	147,679,122	301,564,122
	147,679,122	301,564,122

18. Kapitali

Vlera e kapitalit të nënshkruar më 31 dhjetor 2019 është 47,160 lekë i ndarë në 3 kuota. 1 kuotë në vlerë 7,157.94 lekë zotërohet nga Bradaj 2, 1 kuotë në vlerë 11,158 lekë zotërohet nga Kadria dhe 1 kuotë prej 28,844.06 lekë e zotëruar nga ALB-Building.

Fitimi për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2019 është 257,298,426 ALL. (Për vitin 2018: 388,770,466 ALL).

Fitimi i akumuluar për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2019 është 917,695,726. (Për vitin 2018: 823,428,059 ALL)

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shitje energji elektrike	440,415,725	595,992,721
	440,415,725	595,992,721

20. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Humbje nga këmbimet valutore për marrëdhënie tregtare	433,217	(108,403)
Dëmshpërblim nga kompani sigurimi	-	3,400,000
	433,217	3,291,597

20. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	447,697,612
Shtohen faturimet për tarifen e konçesionit	22,020,786
Zbritet tarifa e koncesionit e muajit dhjetor e cila faturohet në janar 2020	(2,444,620)
Shtohen të ardhura nga këmbimet valutore për marrëdhënie tregtare	433,217
Zbriten të ardhura të përlogaritura në çelje	(26,858,053)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	440,848,942
Sipas Kontabilitetit	440,848,942
Diferenca	-

21. Lënda e pare dhe materiale të konsumueshme

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Mallra të tjerë	1,996,047	1,566,648
Mirëmbajtje dhe riparime	12,792,235	17,580,336
Tatime lidhur me energjinë	22,020,786	29,799,635
	36,809,068	48,946,619

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Blerje, energji, avull, ujë karburant	1,688,924	1,778,854
Shpenzime qiraje	475,372	571,265
Mirëmbajtje dhe riparime	141,487	921,557
Sigurime	1,397,032	1,650,027
Pjesë këmbimi	234,137	1,741,988
Blerje të ndryshme, kancelari	8,292	25,400
Kosto e punimeve	45,450	280,176
Shërbim roje fizike	4,578,700	-
Shpenzime të tjera	4,745,552	5,480,013
Shpenzime transporti	1,615,347	1,185,405
Komisione bankare	104,222	96,824
Taksa të ndryshme	9,012,618	3,114,286
Vlera kontabel neto e aseteve të nxjerra jashtë përdorimi	-	1,324,103
	24,047,133	18,169,898

22. Të tjera shpenzime (vazhdim)

Në shpenzimet e tjera kemi të përfshira edhe shpenzimet për qëllim auditimi vjetor nga shoqëria ILD-99 sh.p.k në vlerën 450,000 Lekë (pa TVSH) dhe shpenzimet për shërbimin e kontabilitetit, ofruar nga personi fizik Dorian Biba në vlerën 210,000 Lekë.

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime paga	14,580,012	14,903,163
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,980,017	2,141,714
	16,560,029	17,044,877

24. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime amortizimi	68,620,621	68,833,618
	68,620,621	68,833,618

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Gjopa dhe dëmshpërblime	-	2,650
	-	2,650

26. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për interesat	(11,546,304)	(13,683,121)
Të ardhura nga interesat	871,521	38,785
	(10,674,783)	(13,644,336)

27. Shpenzimet e tjere financiare

Shpenzimet e tjera financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti financiar	23,953,762	27,865,765
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti financiar	(2,960,905)	-
	20,992,857	27,865,765

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fitimi para tatimit</i>	305,130,165	460,508,085
Total shpenzime të panjohura	13,748,092	17,742,708
AAM jashtë përdorimi	-	1,324,103
Shpenzime amortizimi	12,748,601	12,748,601
Shpenzime të tjera	999,491	3,670,004
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	318,878,257	478,250,793
<i>Tatim fitimi-15%</i>	47,831,739	71,737,619
	257,298,426	388,770,466

29. Palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Hua nga Alb-Building	-	147,679,122	-	301,564,122
	-	147,679,122	-	301,564,122

Shpërblimi menaxhimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është 2,124,756 lekë.

30. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

31. Ngjarje pas bilancit

Në datën 07 shkurt 2020 shoqëria Alb-Building transferoi 15.178% të kuotave të kapitalit tek shoqëria Bradaj 2 shpk. Struktura e re e ortakëve pas kësaj date është:

Shoqëria Alb-Building shpk ka pjesëmarrje prej 61.162%, shoqëria Kadria shpk ka pjesëmarrje prej 23.66% dhe shoqëria Bradaj 2 shpk zoteron 15.178% të kapitalit.

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndër marrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 2.5.3 të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkojnë rregullime ose shënime shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.